

## MASTER EKZEKUTIV NË

### RESTAURIM, KONSERVIM DHE VALORIZIM TË TRASHËGIMISË KULTURORE

[1 VIT | ME KOHË TË PLOTË | 60 KREDITE/ECTS]

#### Profili kulturor dhe profesional

Programi i Studimeve Master ekzekutiv në Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore, organizohet nga Universiteti POLIS në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës me mbështetjen e Drejtorive Rajonale të trashëgimive kulturore (Gjirokastrë, Berat, Korçë), dhe NGO-ve si CHwB, AHF, dhe Insituti i IMK\*.

Programi ka për qëllim pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi praktike për të garantuar një karrierë të suksesshme në fushën e restaurimit, konservimit dhe të vlerësimit të trashëgimisë kulturore në qendrat urbane dhe në zona me karakter të fortë natyror. Veçanërisht studentët do të jenë të aftë të analizojnë në mënyre kritike, gjendjen ekzistuese të trashëgimisë kulturore dhe peisazhistike si dhe të propozojnë më tej ndërhyrjet me të përshtatshme konform me të gjitha zhvillimet bashkëkohore në këtë fushë.

#### Rezultatet e programit të studimit

Në përfundim të Programit Master ekzekutiv në Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore studenti do të jenë i aftë të:

- Kuptojë, analizojë dhe vleresoje gjendjen aktuale të trashëgimisë dhe problematikat emergjente;
- Te hartojë një metodologji të përshtatshme studimi dhe bashkëpunimi me specialiste në fusha të ndryshme specifike;
- Te ketë aftësi drejtuese, menaxhuese dhe përgjegjshmeri në ambientin profesional në çdo fazë të një ndërhyrjeje;
- Të përvetësojë një mënyre kritike të menduarit në marrjen e vendimeve menaxheriale, dhe të ketë aftësi efektive komunikuese;
- Te ketë njohuri të plota në aspektin teorik dhe praktik të fushës së restaurimit dhe të trashëgimisë kulturore dhe natyrore;
- Te jete i aftë në përdorimin e pasqisjeve tradicionale dhe inovative të rievimit dhe të teknikave të ndryshme të restaurimit;
- Te ketë ndjeshmeri artistike dhe njohuri inxhinierike;
- Te vleresoje dhe interpretojë trashëgimie në varesi të nevojave të tregut bashkëkohore.
- Te ketë aftësi kërkimore shkencore.

## **Veprimtaritë formuese, Kreditet**

Programi i studimit i ciklit të dytë "Master Ekzekutiv" në Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore përmban 12 lëndë / module, të cilët përfshijnë tezën e diplomës. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Master Ekzekutiv" në Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore në se plotësojnë 60 kredite sipas sistemit ECTS.

Programi i studimit përmban veprimtaritë formuese të grupuara në disiplina si vijon:

- Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (bazë) 4 kredite
- Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues të programit të studimit 35 kredite
- Veprimtari në disiplina të formimit me zgjedhjen e studentit ndërmjet atyre që ofrohen nga institucioni 9 kredite
- Përgatitja e tezës së diplomës 12 kredite

## **Kërkesat për pranimin në programin e studimeve Master**

Në Programin e Studimeve Master Ekzekutiv në Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore, kualifikohen ata kandidatë që zotërojnë një diplomë Master i Shkencave në profilet: Arkitektura, Inxhinieri Ndertimi, Inxhinieri Mjedis, Planifikues Urban, Mjedis, Histori, Arkeologji (konsulto Ligjin e trashëimisë), apo diploma në fusha të ngjashme me këtë program studimi që do të gjykohen nga komisioni i posaçëm i vlerësimit të programeve në U\_POLIS, apo çdo titull studimi ekuivalent fituar në vende të tjera të njohura nga autoritet zyrtare dhe ligjet në fuqi.

Dokumentacioni i plotë i paraqitur dhe pranuar sipas standarteve të përcaktuara nga MASR dhe Universiteti POLIS, në lidhje me kërkuesin depozitohet pranë sekretarisë mësimore së Universitetit POLIS në momentin e regjistrimit.


Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë:

- Kërkesë me shkrim nga kërkuesi, përfshi sqarimet mbi: programin që dëshiron të ndjekë;
- Diplomën e noteruar të studimeve shoqëruar me listën e noterizuar të notave përkatëse, fotokopje të pasaportës/kartës së identitetit ose certifikatë origjinale me fotografi;
- Të plotësojë kriterin e mesatares;
- Të ketë një rezultat të sukseshme përmes dorezimit të CV-se se plote të karrierës akademike dhe eksperiences në praktike.

\* Përzgjedhja e kandidateve bazohet në vlerësimin e CV me peshën 60 % dhe rezultati i intervistës me peshën 40%.

## **Plan Mësimor sipas tipeve të veprimtarive për programin**

## Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore

 Ndarja e lendeve sipas tipeve të veprimtarive_Master Ekzekutiv në Restaurim, Konservim dhe Valorizim të Trashëgimisë Kulturore					
Kategoria/Komponenti mësimor	Emërtimi i Lëndës	Moduli	Kredite	Kredite total	Kredite (%)
A (LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme) (5 - 10%)	Metodat e kërkimit në arkitekturën bashkëkohore	Kërkimi Shkencor / Ese	6	6	10%
		Workshop Ferrara			
B ( LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore ) (50 - 60%)	Restoration Theory	Restoration Theory	8	34	57%
		Field visits - Albania			
	Restoration Technology "Materials and Techniques"	6			
	Tools for Survey and Documentation	Survey and tools	8		
		Law on Heritage			
	Revitalisation of Heritage Buildings	Workshop Kombetare/Nderkombetare	6		
Repairing and Strengthening Techniques	Reinforcement	6			
	Seismology				
C ( LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTE GRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje ) (12 - 15%)	Histori Arkitekture (History of Architecture)	Shqiptare	8	8	13%
		Boterore			
E ( DETYRIME PËRMBYLLËSE ) (18 - 20%)	Urban and Architectural Restoration Studio	Teori + Praktike + Projekt	12	12	20%
		Practice and field work			
<b>TOTAL</b>			<b>60</b>	<b>60</b>	<b>100%</b>